RAPORTI I KONVENTËS SË INDUSTRISË SË DRURIT TË KOSOVËS

Edicioni i shtatë i Konventës së Industrisë së Drurit është organizuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK), dhe mbështetur nga:
MINT – KIESA, USAID Kosovo Compete Activity, ProCredit Bank, Swisscontact Projekti FEGO dhe Raiffeisen Bank.

PËRMBAJTJA

1. KONVENTA E INDUSTRISË SË DRURIT TË KOSOVË....3
1.1 Qëllimi i Konventës së Industrisë së drurit....3
1.2 Programi i Konventës....4
2.PREZENTIMET GJATË KONVENTËS....6
2.1 Sesioni 1- Industria e drurit, potenciali dhe eksporti....10
2.2 Prezentim - ProCredit me zgjidhje bankare për eksportuesit e përpunimit të drurit....11
2.3 Prezentim - Raporti i sektorit të drurit në Kosovë....12
2.4 Prezentim - Analiza e sektorit të industrisë së drurit në Kosovë - Platforma Digjitale....15
2.5 Prezentimi i Biznesve nga Diaspora për takime B2B....16
2.6 Sesioni 3 - Aktivitetet e donatorëve në industrinë e përpunimit të drurit....17
2.7 Prezentim - GetQuality Software - Si të përmirësohet dhe menaxhohet cilësia....21
2.8 Sesioni 4 - Akademia dhe industria e drurit....22
3. Ekspozimi i produkteve....25
4.1.Takimet Biznes me Biznes - B2B gjatë Konventës së Industrisë së Drurit në Kosovë....27
5. Gara studentore për dizajn - Edicioni i shtatë....28
6.PËRMBLEDHJE....30
7.REKOMANDIME....31

1. KONVENTA E INDUSTRISË SË DRURIT TË KOSOVË

1.1 Qëllimi i Konventës së Industrisë së drurit

Duke qenë një nga sektorët strategjikë të Kosovës, industria e përpunimit të drurit premton të jetë një nga sektorët më të aftë për të rritur më tej ekonominë dhe punësimin e vendit. Prandaj, palët e interesuara, agjencitë dhe qeveria duhet të bashkëpunojnë në krijimin dhe miratimin e strategjive për të vazhduar zhvillimin e kësaj industrie dhe për të thelluar kontributin e saj në rritjen ekonomike
dhe krijimin e vendeve të reja të punë.

SHPDK organizoi Konventën e shtatë të Kosovës për Industrinë e Drurit dhe Garën Studentore për dizajn. Projekti u financua nga: MINT – KIESA, USAID Kosovo Compete Activity, ProCredit Bank, Swisscontact Projekti FEGO dhe Raiffeisen Bank.

Tema kryesore e konventës së këtij viti ishte Fuqizimi i Eksportit, Inovacionit dhe Dizajnit.
Objektivi kryesor i Konventës së Industrisë së Drurit (KWIC) ishte të ofronte një platformë rrjetëzimi për prodhuesit e mobiljeve në Kosovë, agjencitë qeveritare, donatorët, blerësit ndërkombëtarë dhe atyre vendore, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të industrisë së drurit. Pjesë e konventës ishin forume të ndryshme ku ekspertë dhe folës ndërkombëtarë prezantuan tema të ndryshme për industrinë e drurit. Kompanitë kosovare të përpunimit të drurit (26) ekspozuan produktet e tyre për publikun, ndërsa studentët prezantuan dizajnet e tyre të mobiljeve si pjesë e garës studentore në dizajne. Në total, janë mbajtur rreth 81 takime Business-to-Business (B2B). Në fund, të gjithë studentët pjesëmarrës në konkurs morën certifikatat e pjesëmarrjes, ndërsa fituesit e konkursit studentor morën çmimet e tyre.

Edicioni i shtatë i KWIC përbëhej nga një forum biznesi në të cilin kompanitë kosovare prezantuan historitë e tyre të suksesit të eksportit dhe sfidat me të cilat përballen në industri. Për më tepër, tema të tjera ishin E-Commerce dhe Digjitalizimi në industrinë e drurit, Aktivitetet e donatorëve në industrinë e përpunimit të drurit, Akademia dhe industria e drurit etj.

Objektivat e arritura të Konventës së Industrisë së drurit ishin:

- Konkurrueshmëria, potenciali, eksportet, financimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit në Kosovë.
- E-commerce dhe digjitalizimi në industrinë e drurit.
- Mbështetja nga partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe institucionalë në Kosovë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e sektorit të drurit dhe mobiljeve për punësimin dhe rritjen ekonomike.
- Bashkëpunimi mes akademisë dhe sektorit privat për promovimin dhe zhvillimin e inovacionit

Duke mbuluar një gamë të gjerë çështjesh, si dhe duke paraqitur dhe promovuar dizajne dhe produkte vendore, Konventa u ofroi pjesëmarrësve të saj një mundësi unike për të diskutuar, analizuar dhe mësuar, si dhe për të krijuar marrëdhënie biznesi dhe për të prezantuar produktet e tyre.
Konventa e shtatë e Industrisë së Drurit, ishte një ngjarje njëditore që u zhvillua në Hotel Emerald më 26 nëntor 2024. Ngjarja ishte me shume panele diskutime dhe prezentime. Krahas paneleve dhe sesioneve B2B, SHPDK organizoi një ekspozitë të produkteve të kompanive dhe një ekspozitë të finalistëve në Garen Studentore për Diazjn që u mundesua nga bashkëpunimi i ngushtë me katër Universitetet e dizajnit dhe arkitekturës.

1.2 Programi i Konventës

- Historitë e suksesit mbi eksportet dhe sfidat e industrisë, digjitalizimi dhe aktivitetet tjera në Konventën e Industrisë së Përpunimit të Drurit u organizuan si një ngjarje njëditore me tematika të ndryshme. Këto panele mbulojnë çështjet kryesore të konkurrencës, duke adresuar temat e rëndësishme si gjendja gjeneruese e sektorit të përpunimit të drurit në Kosovë, trendet, dizajnet dhe eksportet në BE, qasjen financiare me eksportin, dhe sfidat e zhvillimit të fuqisë punëtore. Gjithashtu u trajtua çështja e digjitalizimit në industrinë e përpunimit të drurit, si dhe u prezantuan aktivitetet e donatorëve në Kosovë. Në të gjitha temat qe u diskutuan, audiencës i'u prezantuan mbështetjet e donatorëve në forma të ndryshme, duke synuar drejtimin e këtij sektori drejt sukseseve dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

- Panairi i Produkteve, i hapur për tregtarët, mediat dhe të gjithë pjesëmarrësit e KWIC 2023, ka për qëllim të ofrojë një përshtypje të fortë të aftësive të përgjithshme të sektorit të drurit të Kosovës dhe të shërbejë si prezantim për blerësit, shitësit, dhe agjentët e pranishëm. Në këtë panair u shfaqën produkte të zgjedhura nga druri i ngurtë, dollapë, dyer, dritare, kuzhina, tavolina, karrika, kulma nga druri, ndërtimin e shtëpive të prefabrikuara, elementë të tjerë të dizajnit të brendshëm si dhe materiale dhe mekanizma për fushën e mobilerise dhe produkteve nga druri. Kjo platformë ofroi një mundësi për të promovuar prodhimet dhe kreativitetin e sektorit të drurit në Kosovë, duke përmirësuar njohuritë dhe bashkëpunimin në fushën e përpunimit të drurit.

- • Takimet Business-to-Business u organizuan si pjesë e konventës, ku kompanitë vendore dhe ndërkombëtare ndërvepruan dhe shkëmbyen informacione me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të pranishëm në KWIC 2024. Qëllimi i këtyre takimeve ishte të ofronin një mundësi për prodhuesit kosovarë për tu takuar dhe diskutuar me agjentët e shitjeve dhe blerësit pjesëmarrës. Kjo platformë siguroi një ambient për bashkëpunim, dhe rrjetezim ne shkembim te njohurive të reja, duke ndihmuar në zhvillimin e marrëdhënieve biznesore dhe krijimin e mundësive të reja në treg.

- Gara studentore për dizajn u organizua nga SHPDK në bashkëpunim me Universitetet me qëllim të vendosjes së konturave të një bashkëpunimi të vazhdueshëm dhe të përhershëm. Fillimisht gara studentore për dizajn është organizuar brenda Universiteteve dhe më pas finalistët paten mundësi ti ekspozojnë punimet e tyre në Konventë duke u shpërblyer me Certifikata si dhe u ndane çmimet për 3 vendet e para. Punimet e studentëve u vlerësuan nga një juri e pavarur, dhe fituesit u shpallën gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve në pjesën përfundimtare të Konventës. Ky koncept synon të inkurajojë krijimtarinë dhe inovacionin në fushën e dizajnit studentor dhe industrisë së drurit.



2.PREZENTIMET GJATË KONVENTËS

SHPDK kishte nderin ti kishte të pranishem në hapje të Konventës: Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës, Zenel Kelmendi, Kryetar i bordit të SHPDK-së, Rozeta Hajdari, Ministre e MINT-it, Brian K. Wittnebel nga USAID Economic Growth Office, Jonas Westerlund, Ambasador i Suedisë në Kosovë, Eric Dietz, Shef i Ambasadës së Luksemburgut në Kosovë.



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI

para të pranishmëve, në fjalën e tij hyrëse tha se industria jonë e përpunimit të drurit ka parë rritje mbresëlënëse, ku eksportet vetëm në tre tremujorin e parë të këtij viti kanë arritur nivelin total të vitit të kaluar. “Ne kemi rreth 1,000 kampionë të mobilerisë, që formësojnë aktivisht këtë sektor, një dëshmi e përkushtimit, produktivitetit dhe krijimtarisë së tyre. Zvicra kryeson si destinacioni kryesor për eksportet tona të mobileve, e ndjekur nga Gjermania. Pra, me plot gojën mund të themi se Kosova po e gdhend një vend të veçantë në tregun global”, u shpreh Kyreministri Kurti. Ai tha se si shtet, aspirojmë që të jemi më të mirët në Ballkanin Perëndimor, jo vetëm në demokraci, sundim të ligjit, pluralizëm politik, të drejta të njeriut, rritje të brutoproduktit vendor dhe shifra tregtare, por edhe në kultivimin e një fryme të inovacionit e të bashkëpunimit. Strategjia jonë kombëtare për zhvillimin e këtij sektori e ka mbështetjen e plotë të secilës ministri, jo vetëm thjeshtë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, po të secilës ministri, të secilës drejtori edhe timin si kryeministër, tek i cili nuk duhet ta shihni vetëm dikë që garanton me sundim të ligjit konkurrencën e lirë dhe fer, por gjithashtu edhe bashkëpunimin e partneritetin si një infrastrukturë politike e institucionale për rritjen tuaj biznesore dhe ekonomike”, deklaroi kryeministri Kurti. Në përfundim të fjalës së tij, ai tha se, shkathtësia për të ndryshuar, qëndrueshmëria dhe inovacioni–këto nuk janë thjesht fjalë; ato janë thelbi i identitetit tonë. Këto vlera e bëjnë Kosovën vendin e duhur për të investuar, bashkëpunuar dhe për t’u rritur.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari gjatë fjalës së saj theksoi se industria e drurit përfaqëson një komponent të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor të vendit duke shtuar se përmes rritjes së vazhdueshme dhe përmirësimit të eksporteve, ky sektor ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e deficitit tregtar dhe ka shënuar suksese të mëdha në tregjet ndërkombëtare si Zvicra, Gjermania, Italia, SHBA dhe rajoni më i gjerë. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit dhe akterë të tjerë të industrisë dhe akademisë, ka hartuar Strategjinë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit – Politika Industriale 2030. Kjo strategji, pjesë e Agjendës së Reformave të Kosovës dhe Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor të BE-së, ka identifikuar industrinë e drurit dhe të mobiljeve si një "Yll në rritje" me potencial të lartë për zhvillim, duke kontribuar me 10% në Vlerën e Shtuar të Produktit dhe 20% të punësimit në sektorin përpunues, potencoi Ministrja Hajdari. Ajo tha se MINT ka mbështetur vazhdimisht ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të këtij sektori përmes skemave financiare për avancimin e teknologjisë, standardizimin, certifikimin, dixhitalizimin dhe pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare si Swiss Bau, Stockholm Furniture dhe panairi i Selanikut. MINT mbetet e përkushtuar në mbështetjen dhe fuqizimin e industrisë së drurit si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Me këtë rast, **kryetari i bordit të Shoqatës për Përpunimin e Drurit të Kosovës (SHPDK-së), Zenel Kelmendi** tha se kjo ngjarje sot e organizuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit është nje platformë rrjetizimi për përpunuesit e drurit, agjencitë qeveritare, donatorët të cilët janë të përfshirë në programe dhe projekte për zhvillimin e kësaj industrie dhe duke shtyer zhvillimin ekonomik të Kosovës në përgjithësi. Si kryetar I Bordit të Shoqatës së Përpunuesve të Drurit jemi krenar me të arriturat e kësaj industrie. Përmes punës së palodhshme dhe investimeve të mëdha qe kjo industri po bën në vazhdimësi, kompanitë kosovare të përpunimit të drurit kanë ngritur kualitetin e produkteve dhe reputacionin në nivel ndërkombëtar. Kompanitë Kosovare tashmë eksportojnë produktet e tyre në Evropë dhe së fundmi edhe në SHBA dhe kjo na tregon që industria e drurit kontribon dukshëm në zhvillimin ekonomik prandaj ta përgëzojmë këtë industri dhe ta përkrahim në rritjen e eksportit përmes investimeve të menqura të teknologjisë dhe inovacionit dhe promovim më të madh në arenen ndërkombëtare.

Brian K. Wittnebel nga USAID Economic Growth Office, duke përshëndetur të pranishmit, ai theksoi se ishte kënaqësi të bashkohej në këtë edicion të shtatë të Konventës së Industrisë së Drurit. Ai shtoi se mbështetja e USAID për sektorin e drurit ka mundësuar nënshkrimin e ngjarjeve që kanë ndihmuar Kosovës të fitojë një vend të rëndësishëm në arenën globale dhe të krijojnë mundësi ekonomike. Ai theksoi se, herë pas here, ka parë se kompanitë nga ky sektor kanë pasur një ndikim të madh në nivel global.

Një nga shembujt më të mirë është kompania VATER, pronari i së cilës, Shkelqim Ajazi, ka komunikuar me ta vetëm javën e kaluar. Vetëm tri vjet më parë, ata nuk kishin asnjë prani jashtë Kosovës, duke filluar si një biznes familjar në Prizren. Pas pjesëmarrjes së tyre në Swiss Bau në vitin 2022, ata kanë nisur projekte të mëdha në Zvicër. Ky është një shembull i zhvillimit të mundshëm që ka pasur sektori i drurit në Kosovë. Në fakt, vetëm për periudhën 2019-2022, industria e drurit ka gjeneruar më shumë se 200 milionë euro në shitje eksporte për vendin. Kompani si VATER kanë përmirësuar reputacionin e Kosovës në nivel ndërkombëtar. Ai përfundoi duke falenderuar të gjithë për punën e tyre dhe për mundësitë që po krijojnë për zhvillimin e këtij vendi, duke treguar botës se çfarë mund të arrijë sektori privat në Kosovë.

Jonas Westerlund, Ambasador i Suedisë në Kosovë, theksoi se është gjithmonë kënaqësi të jetë në Konventë. Ai shtoi se Suedia mbulon 70% të territorit të saj me pyje dhe vlera e eksporteve të produkteve të drurit arrin në 20 miliardë dollarë, që përbën 20% të eksporteve suedeze. Kompanitë suedeze janë gjithashtu pronarët më të mëdhenj të pyjeve në Europë. "Ne jemi shumë të kënaqur të punojmë me Kosovën dhe industrinë e drurit dhe atë të mobiljeve. Suedia ka gjithsej 2400 kompani në industrinë e mobiljeve, kështu që, nëse bashkojmë drurin dhe mobiljet, shoh mundësi të mira për bashkëpunim," tha ai. Ambasadori theksoi se janë duke punuar ngushtësisht dhe financuar projektin FEGO, dhe janë të lumtur që, për herë të parë, kishin mundësinë të ekspozonin kompanitë kosovare në Suedi, me mbështetje nga KIESA. "Ne patëm tre kompani mobiljesh nga Kosova javën e kaluar dhe shumë kompani të tjera priten të vijnë. Nëse dëshironi të kontaktoni me kompani suedeze të drurit dhe mobiljeve, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni KIESA, Ambasadën suedeze ose Swisscontact," shtoi Westerlund. Ai përmendi gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me USAID, e cila është lider në këtë fushë.

Eric Dietz, Shef i Ambasadës së Luksemburgut në Kosovë tha se është një kënaqësi e madhe të drejtohem sot para jush në këtë tubim të rëndësishëm të industrisë së përpunimit të drurit në Kosovë. Ky sektor është bërë një shembull i shkëlqyer i krijimtarisë, mjeshtërisë dhe angazhimit të Kosovës për përparimin ekonomik. Si Ambasador i Luksemburgut, jam i nderuar të mbështes dhe të festoj këto arritje së bashku me ju. Vizita e fundit e Shoqatës së Drurit të Luksemburgut në Kosovë theksoi potencialin e madh të industrisë suaj. Delegacioni u impresionua nga cilësia e produkteve, inovacioni i dukshëm në proceset tuaja dhe përkushtimi i kompanive të Kosovës. Ishte e qartë se industria e përpunimit të drurit në Kosovë është në rrugën e duhur për t'u bërë një lojtar konkurrues në tregun global. Po ashtu, delegacioni ndau disa rekomandime për të ndihmuar bizneset kosovare të rriten më tej.

Tre fusha kryesore për përmirësim u identifikuan: forca e marketingut, krijimi i listave të çmimeve konkuruese dhe zhvillimi i strategjive aktive të shitjeve. Këto hapa janë thelbësore për të pozicionuar Kosovën si një partner të besueshëm dhe tërheqës ndërkombëtarisht. Luksemburgu mbetet i angazhuar për të mbështetur Kosovën në përballimin e këtyre sfidave. Duke punuar së bashku, mund të forcojmë bashkëpunimin, të ndajmë ekspertizën dhe të eksplorojmë mundësitë për rritje. Ne besojmë se industria e përpunimit të drurit në Kosovë ka potencialin të lulëzojë jo vetëm në nivel rajonal, por edhe globalisht, si një simbol i cilësisë dhe inovacionit.





















2.1 Sesioni 1 - Industria e drurit, potenciali dhe eksporti

Paneli i Industrisë së drurit, potenciali dhe eksporti u moderua nga Dren Zatriqi, USAID Kosovo Compete Activity dhe të ftuar në këtë panel ishin këta folës: Suzana Harxhi, CEO Bizzarro, Argurjan Hoti, CEO Hoti Excluzive, Ideal Vejsa , CEO Maden Group, Burim Bajraktari, CEO Modium L.L.C, Zamira Pode, Eksperte e Marketingut, Luxemburg.

Qëllimi kryesor është të sigurojë një pamje të plotë dhe të shtruar të sektorit të industrisë së drurit, duke përfshirë potencialin e tij për zhvillim dhe rritje, si dhe sfidat dhe mundësitë në tregun e eksportit.

Ndër pyetjet kryesore drejtuar panelistëve ishin: Ku e shihni të ardhmen e industrisë së drurit në një periudhë afatmesme, dhe cili është trendi që duhet të ndjekim si industri?



Suzana Harxhi, CEO i kompanisë Bizzarro, theksoi se një nga trendet e fundit që është ndjekur është inovacioni. Megjithatë, ajo theksoi se, sipas mendimit të saj, për një eksport të suksesshëm ose një strategji të mirë eksporti, cilësia e produktit është shumë më e rëndësishme. Ajo shtoi se një tjetër aspekt me rëndësi ka qenë pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare, e cila ka sjellë shumë feedback pozitiv.

Argurjan Hoti, CEO i kompanisë Hoti Exclusive, duke qenë një nga anëtarët e shoqatës, ka ndjekur me vëmendje rritjen e industrisë dhe ka përmendur disa kritere që kanë evoluar shumë. Qasja e tij është të fokusohemi në prodhime cilësore, por ai theksoi se mbështetja dhe pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare kanë qenë të rëndësishme. Ai po ashtu e theksoi rëndësinë e promovimit dhe lehtësimit të daljes në tregjet e jashtme, duke shtuar se si prodhues kanë mësuar se çfarë kërkon tregu ndërkombëtar. Për sa i përket të ardhmes së industrisë së drurit, Hoti tha se, pavarësisht sfidave, ata janë në një rrugë të mirë, pasi tregu i Evropës është mjaft i madh. Ai përmendi se çdo vit ata përparojnë dhe bëhen më të gatshëm për tregun ndërkombëtar, duke theksuar se industria po rritet dhe do të jetë gjithmonë në përmirësim.

Zamira Pode, Eksperte e Marketingut nga Luksemburgu, tha se Kosova ka talente të fshehura dhe që prej disa vitesh ka kompani që bëjnë biznes në Luksemburg. Ajo theksoi se detyra jonë është të promovojmë këto produkte druri dhe mobilje, dhe se nxitja dhe bashkëpunimi me Luksemburgun mund të jenë një hap i rëndësishëm drejt integrimit evropian. Endrra ime është që produktet 'Made in Kosovo' të marrin sinergjinë e duhur, duke promovuar cilësinë që përmbush standardet ekologjike dhe që tregon për një forcë punëtore me vullnetin e duhur, që prodhon sipas standardeve që kërkon tregu ndërkombëtar. Unë jam shumë optimiste dhe, të paktën në Luksemburg, do të bëj maksimumin, sepse ne jemi dy shtete të vogla dhe kur ka vullnet dhe sinergji, natyrisht që edhe marka do të konsolidohet. Ajo theksoi gjithashtu se Kryeministri i Luksemburgut e ka vizituar dy herë Kosovën, gjë që tregon një interes të madh për këtë bashkëpunim. "Kam kontaktuar edhe me kompanitë dhe ato janë me mendime pozitive. Dhe, për të qenë e sinqertë, jam shumë e kënaqur që produktet e vizituara në kompanitë kosovare ishin në nivele të larta.

Ideal Vejsa, CEO i kompanisë Maden Group, theksoi se ai përfaqëson profesionin e Arkitektit, i cili është faza e parë e produktit, pra faza e dizajnit. Sipas tij, si shqiptarë jemi shumë të guximshëm, dhe guximi ynë ka bërë që produktet tona të jenë inovative dhe të ofrojnë mundësi të mira për prodhim. Sa i përket dizajnit, ne kemi dhënë një kontribut të mirëfilltë në industrinë e drurit, ndërsa pjesa e standardeve dhe cilësisë kërkon më shumë përkushtim. Për të qenë të suksesshëm, gjithmonë duhen disa faktorë, dhe në këtë rast, Shoqata e Drurit mendoj se është një shembull për të gjitha shoqatat në Kosovë. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në avancimin e industrisë dhe sot ne shohim një industri të suksesshme, ku barra më e madhe bie mbi shoqatën, por gjithashtu dhe mbi qeverinë, si dhe donatorët, si USAID.

Burim Bajraktari, CEO i Modium L.L.C, tha se është e rëndësishme të theksohet se industria kosovare e drurit ka kaluar një fazë të rëndësishme, duke zgjeruar eksporte në tregjet ndërkombëtare dhe botërore. Projeket e rëndësishme dhe referuese janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen nga kompanitë kosovare. Gjatë viteve të fundit, nga pozita e arkitektit, kemi qenë të angazhuar në disa projekte, ku kemi arritur të identifikojmë përparësitë, por edhe të metat ose ngecjet e prodhuesve kosovarë në krahasim me projektet ndërkombëtare. Për shkak se vij nga aspekti teknik, isha fokusuese në këtë pjesë, e cila e shoh si një barrierë. Nëse kjo barrierë kalon, eksporti ndërkombëtar mund të arrijë kapacitetet maksimale. Sa i përket linjave të prodhimit dhe teknologjisë, kompanitë kosovare kanë bërë përparime të mëdha. Përgatitja e stafit është në nivelin evropian dhe botëror, dhe materialet dhe aksesorët janë të njëjtë me ata të fabrikave të prodhuesve të huaj. Megjithatë, një barrierë që unë e shoh është faza fillestare dhe komunikimi, pasi si prodhues ose investitor, shpesh ka një nxitim për të arritur deri te ofertimi. Kjo çon në kalimin e specifikacioneve teknike dhe kërkesave të investitorëve të jashtëm, duke munguar analizimi dhe ofertimi teknik i duhur, si dhe matjet e sakta. Këto janë aspekte të thjeshta që mund të rregullohen shumë shpejt.

2.2 Prezentim - ProCredit me zgjidhje bankare për eksportuesit e përpunimit të drurit



Besnik Haziri, Udhëheqës i Departamentit të Biznesit, ProCredit Bank, gjatë prezantimit të tij theksoi se si bankë, ProCredit është një pjesë aktive e ekonomisë në vendin tonë. Ai theksoi se banka mbështet aktivisht bizneset lokale në zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre. Sipas tij, përpunuesit e drurit japin një kontribut të jashtëzakonshëm në ekonominë kosovare, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, dhe kur jemi te zhvillimi ekonomik vlen të theksohet se ProCredit është një bankë zhvillimore që fokusohet në mbështetje dhe rritje të qëndrueshme të bizneseve prodhuese. ProCredit Bank, sipas Hazirit, është banka e parë e themeluar në Kosovën pas luftës, dhe ka sjellë me vete praktikat më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe shërbimeve bankare. Ai theksoi se banka ka qenë gjithmonë një pionier në ofrimin e shërbimeve inovative dhe të përshtatura për kërkesat e tregut kosovar. Si një bankë që ka një fokus të fortë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, ProCredit është e angazhuar për të mbështetur sektore të ndryshëm, duke përfshirë industrinë e drurit, që është një nga sektorët kryesorë që kontribuon në ekonominë e Kosovës. Haziri gjithashtu theksoi se ProCredit Bank ofron një gamë të gjerë shërbimesh financiare për klientët e saj, duke përfshirë kredi për investime, si dhe shërbime të tjera që i ndihmojnë bizneset të përballen me sfidat e përditshme të menaxhimit financiar. Ai përmendi gjithashtu rëndësinë e mbështetjes së qëndrueshme dhe fleksibël që banka ofron për të ndihmuar klientët të arrijnë objektivat e tyre afatshkurtra dhe afatgjata, duke krijuar mundësi për zhvillim dhe rritje të mëtejshme të biznesit të tyre. Në përfundim, ai nënvizoi se për ProCredit Bank është shumë e rëndësishme që të mbetet gjithmonë pranë bizneseve prodhuese, për të ofruar mbështetje dhe për të siguruar që ato të mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

2.3 Prezentim - Raporti i sektorit të drurit në Kosovë



Arieta Vula Pozhegu, drejtoreshë Ekzekutive e SHPDK-së fillimisht falenderoi të gjithë të pranishmit në Konventë, përfaqesues të ambasadave, ministrive, donatorët, sponsorët dhe të gjithë akteret që bënë të mundshëm realizimin e Konventës, dhe jo vetëm sepse këta sponzorë janë mbeshtetesit e SHPDKsë në udhetimin tonë dhe në të gjitha aktivitetet qe i kemi realizuar në 20 vitet e fundit.
Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës sot shënon 20-vjetorin e themelimit, një shoqatë e krijuar nga 50 kompani që në vitin 2004 u mblodhën dhe, me ndihmën e USAID-it dhe GTZ-së, themeluan Shoqatën e Përpunuesve të Drurit. Sot, në edicionin e 7-të të Konventës, kemi nderin të shohim një prani të madhe të industrisë, përfaqësues të biznesve të diasporës, mysafirë nga Shqipëria dhe nga vende të ndryshme të rajonit. Në prezantimin e raportit vjetor të SHPDK-së, znj. Arieta Vula Pozhegu ofroi një kronologji të aktiviteteve dhe përpjekjeve për fuqizimin dhe promovimin e vazhdueshëm të sektorit të drurit në Kosovë. SHPDK ka kontribuar në ndërkombëtarizimin e industrisë së drurit të Kosovës, duke promovuar mbi 60 kompani gjatë vitit 2024. Po ashtu, përmes rrjetëzimit dhe organizimeve të takimeve B2B, ku morën pjesë rreth 300 individë, janë mbështetur edhe programe praktike dhe punësimi në industrinë e drurit, me 128 kandidatë në praktikë dhe 58 të punësuar. Përveç kësaj, SHPDK ka ofruar shërbime të reja për anëtarët, duke përfshirë platformën e re të SHPDK-së dhe e-commerce. Ekspozimet ndërkombëtare dhe efekti i takimeve B2B janë investime të frytshme për rritjen e eksportit.

Disa rezultate konkrete janë:

- Rezultatet e eksportit: 5,300,000 Euro
- Promovimi i anëtarëve në media sociale në vazhdimësi
- Mbi 360 pjesëmarrës në Konventë
- Platforma e re e SHPDK dhe E-commerce: https://kosovowood.org/
- Katalogu i industrisë së drurit:

https://kosovowood.org/Uploads/Page/Document/20/awpk_final_ALB.pdf

- Harta e industrisë së drurit: https://kosovowood.org/Harta-Interaktive
- Analiza/Statistikat e industrisë së drurit: https://www.workforcedata-ks.org/wooddashboard

2.4 Prezentim - Analiza e sektorit të industrisë së drurit në Kosovë - Platforma Digjitale



Donika Macastena, Menaxhere e Angazhimit të Sektorit Privat në Aktivitetin e USAID për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore përmes Sektorit Privat, gjatë prezantimit të saj foli për një platformë digjitale të re, e cila është zhvilluar me mbështetje të Aktivitetit të USAID për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore përmes Sektorit Privat. Kjo platformë është tashmë e disponueshme në web të SHPDK-së, dhe ofron informacion të detajuar në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Macastena theksoi rëndësinë e kësaj platforme si një mekanizëm mbështetës për Këshillin e Fuqisë Punëtore të industrisë së drurit, i cili udhëhiqet nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës. Ajo theksoi gjithashtu se platforma është e dizajnuar për të shërbyer si një burim informacioni dhe mbështetje për të gjithë aktorët kyç, përfshirë politikbërësit, ata që marrin vendime dhe përfaqësuesit e këtij sektori, për të mundësuar zhvillimin dhe rritjen e fuqisë punëtore. Duke vazhduar, Macastena bëri një përmbledhje të funksionaliteteve të platformës dhe prezantoi të dhënat dhe statistikat që janë nxjerrë nga institucionet përkatëse. Kjo platformë gjithashtu ndihmon në krijimin e mundësive për rritjen e ndërveprimit mes aktorëve të ndryshëm, duke siguruar informacion të saktë dhe të përditësuar që mund të përdoret për strategjitë e zhvillimit të këtij sektori.

2.5 Prezentimi i Biznesve nga Diaspora për takime B2B



Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, në bashkëpunim me CUT TO CREATE MEDIA L.L.C., ka organizuar një ngjarje me qëllim përmirësimin e qasjes në eksport dhe tregje të reja, duke u fokusuar në promovimin dhe rritjen e mundësive për bizneset e Kosovës. Pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe bizneset e diasporës, të cilat morën pjesë në Konventën e Industrisë së Drurit të mbajtur më 26 Nëntor në Kosovë. Pjesëmarrja e 11 kompanive nga diaspora në këtë ngjarje ishte një vlerë e shtuar, pasi ato u prezantuan para audiencës dhe vazhduan me takime B2B, të cilat ndihmuan në forcimin e lidhjeve dhe mundësive të bashkëpunimit ndërkombëtar.

2.6 Sesioni 3 - Aktivitetet e donatorëve në industrinë e përpunimit të drurit



Zef Dedaj, U.D. Drejtor i KIESA, duke përmbledhur aktivitetet e vitit, theksoi se buxheti i KIESA-s ka qenë rreth 14 milionë euro. Nga ky buxhet, 7.2 milionë euro janë përdorur për subvencione dhe grante, ndërsa pjesa tjetër është investuar në projekte kapitale dhe për mallra e shërbime, ku rreth gjysmë milioni janë dedikuar për këtë kategori. Nga 7.2 milionë euro për subvencione dhe grante, janë zbatuar 6 skema të granteve, ku sektori i përpunimit të drurit ka qenë një nga sektorët kryesorë që ka përfituar. Në këtë sektor janë financuar blerje makinerish përpunuese dhe prodhuese, ku 70% e përfituesve kanë qenë të rinj, me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e eksportit. Po ashtu, janë mbështetur skemat për certifikimin e produkteve, duke mundësuar që produktet të certifikohen me markën CE, që nënkupton mundësinë e eksportit pa probleme. Sektori i përpunimit të drurit ka përfituar gjithashtu nga skemat për inovacion, digjitalizim dhe për panaire, ku janë organizuar pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, si në Basel të Zvicrës në panairin Swiss Bau, ku morën pjesë 12 kompani nga Kosova, dhe në panairin Stockholm Furniture Fair në Suedi. Ky sektor ka përfituar praktikisht nga të gjitha skemat e granteve, përfshirë pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare. Gjithashtu, sapo është inaguruar puna për Parkun Industrial 2 në Drenas, i cili është projekti më i madh me një sipërfaqe prej 36.5 hektarësh dhe parashikohet të ketë 50 parcela. Ky projekt pritet të përfundojë brenda një viti dhe do të ofrojë mundësi të mëdha për zhvillimin e sektorit, pasi ky sektor do të gjejë një hapësirë më të madhe për rritje dhe zhvillim. Rrjedhimisht, të gjitha aktivitetet që janë zbatuar këtë vit do të fuqizohen edhe më shumë vitin tjetër.


Skender Rama, Drejtor i Projektit për USAID Kosovo Compete Activity, theksoi se tashmë janë në vitin e fundit të projektit 5-vjeçar dhe shprehu shpresën që USAID të vazhdojë të mbështesë sektorin e drurit, si dhe sektorët tjerë që kanë potencial për zhvillim në të ardhmen në Kosovë. Sektori i drurit, në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës dhe në partneritet me KIESA-n, ka qenë gjithmonë një fushë aktiviteti që ka përparuar gjatë katër viteve të kaluara.

Paraqitja e përbashkët në Swiss Bau ka qenë e jashtëzakonshme, sepse ka ndikuar në ndryshimin e perceptimit mbi cilët janë kosovarët si prodhues dhe çfarë mund të ofrojnë ata. Për të kaluarën mund të flasim shumë, por për të ardhmen kemi më pak se 1 vit në dispozicion për implementimin e projektit. Megjithatë, një lajm i mirë që mund të ndaj është se dje kemi shpallur një thirrje të re me një shumën jo aq të madhe, rreth 200,000 euro, ku vlera maksimale e aktiviteteve nuk mund të kalojë 80,000 euro, dhe po flasim për aktivitete që duhet të zgjasin më së shumti 6 muaj për shkak të kohës së kufizuar.

Agnesa Jashari, Këshilltare në kabinetin e Zv. Kryeministrit të Parë, duke prezantuar agjencinë e re për investime dhe eksport në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, theksoi se kjo agjenci do të fillojë operimin gjatë vitit të ardhshëm. Ajo përmendi se, pas disa analizave të bëra, është vërejtur se sektori i përpunimit të drurit nuk është vetëm një sektor me potencial, por ka pasur zhvillim të madh. Kjo ka bërë që të jepet një fokus i veçantë këtij sektori në kuadër të planit të agjencisë. Idetë kryesore të agjencisë do të jenë promovimi i kompanive lokale me potencial për eksport dhe tërheqja e investimeve të jashtme. Në bazë të një kalendari të detajuar, agjencia do të mbulojë disa aktivitete kryesore, përfshirë pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare, forume lokale për këtë sektor, dhe mbështetje të vazhdueshme për organizimin e Konventës. Po ashtu, është vendosur që SHPDK-ja të mbështetet më shumë në aktivitete dhe të ketë një angazhim më të madh nga agjencia në realizimin e projekteve të ndryshme për zhvillimin e sektorit të përpunimit të drurit.

Agon Dula, nga Projekti i Fondeve të Angazhimit të Sektorit Privat, theksoi se, për dallim nga projektet e tjera, fondet e këtij projekti janë të fokusuar në angazhimin e sektorit privat. Ai theksoi se synohet angazhimi i bizneseve që kanë kaluar fazat e zhvillimit dhe kanë krijuar zgjidhje inovative, me qëllim që ato t'i zhvillojnë më tej për të pasur një ndikim të madh në tregun e gjerë. Për shembull, në industrinë e drurit, bizneseve që kanë mundësi të menaxhojnë mbeturinat, do t'u ofrohen mundësi financimi përmes dy granteve që sapo janë lansuar: Fondi i Sfides dhe Fondi i Demonstrimit. Ai shpreson që ky mundësi të shfrytëzohet nga sa më shumë biznese dhe të kenë aplikime të shumta.

Artan Avdiu, Udhëheqës i projektit "Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik i Kosovës" CDF theksoi se ky projekt është i dizajnuar për të mbështetur kategoritë e veçanta të biznesve, si ata të grupeve të minoriteteve dhe grave në biznes. Ai theksoi se do të vazhdojnë bashkëpunimin me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit dhe sektorin e përpunimit të drurit, pasi që ekzistojnë mundësi grantesh dhe ka interes të madh për t'u përfshirë në këto mundësi. Projektet e këtij programi kanë një limit të caktuar për vitin 2025 dhe një buxhet të cilin bizneset mund ta përdorin për të përfituar deri në 10,000 euro, një mundësi që i përket ndërmarrjeve të vogla. Deri tani, janë shpërndarë 160 grante. Për sa i përket pjesës për asistence teknike Artani theksoi se të gjitha gratë në biznes që kanë nevojë për mbështetje janë të hapur për ndihmë, për të cilën kanë arritur marrëveshje edhe me EBRD-në.



Edona Nahi, Menaxhere e Komponentës së Programit "Fit for Jobs", GIZ Kosovo, tha se tani janë në fazën e dytë të projektit që sapo ka startuar, ku objektivi është i njëjtë – përkrahja e punësueshmërisë së të rinjve dhe grave, me fokus në sistemin e zhvillimit të arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe mbështetja e tranzicionit të punëkërkuesve në tregun e punës. Partnerët kryesorë në këtë projekt janë Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës. Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe një buxhet prej rreth 5.5 milionë eurosh. Tri objektivat tona kryesore janë: Mbështetja e partnerit tonë në implementimin e nevojave për reformimin e arsimit dhe aftësimit profesional, duke përfshirë elementet e tranzicionit të gjelbër dhe digjital, përmirësimi i cilësisë së arsimit dual, i cili ka filluar me 12 profile, kalimi i punëkërkuesve në punësim. Një element i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi me shoqatat dhe odat e biznesit, i cili është thelbësor për implementimin e këtyre objektivave.

Anton Gojani, Facilitues Kryesor për Zhvillimin e Agjencisë VET të Kosovës, MSJ Project - SDC Funded, theksoi se, duke qenë se jemi në fazën fillestare të projektit, do t'i përmend shkurtimisht pikat kryesore. Projekti ynë kryesorisht merret me zhvillimin e shkathtësive dhe ka dy komponentë kryesore: e para ka të bëjë me përmirësimin e qeverisjes në arsimin dhe aftësimin profesional në aspektin institucional, ndërsa e dyta përfshin mbështetjen e sektorit privat për rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve dhe forcimin e bashkëpunimit mes dy sektorëve, atij publik dhe privat.

Vesa Shehu, Koordinatore Rajonale e Fondit të Sfida Rajonale / Fondi i Sfida e Kosovës – Fond i financuar nga KfW dhe SDC, duke i prezantuar dy fondet që kanë për qëllim rritjen e punësueshmërisë, theksoi se kjo bëhet përmes forcimit të konkurrueshmërisë së kompanive. Mbështetje ofrohet përmes granteve që krijohen në partneritet ndërmjet institucioneve të aftësimit profesional dhe kompanive partnere. RCF operon në nivel rajonal dhe financohet nga qeveria gjermane me një fond prej 64.4 milion euro, ndërsa në thirrjen e tretë, qeveria zvicerane, përmes SDC, është bashkuar me një kontribuim prej 10 milion eurosh. Ky fond ishte planifikuar të përfundojë deri në vitin 2025, por për shkak të interesimit të madh dhe aplikimeve, ai është shtyrë deri në vitin 2027, me mundësi vazhdimi. Kosova nga këto dy fonde ka fituar rreth 22 milion euro për investime direkte dhe është investimi më i madh i donatorëve për aftësimin profesional.

2.7 Prezentim - GetQuality Software - Si të përmirësohet dhe menaxhohet cilësia

Një pjesë kyçe e Edicionit të 7-të të Konventës së Industrisë së Drurit ishte fokusi në digjitalizimin dhe inovacionin, elemente thelbësore për zhvillimin dhe transformimin e kësaj industrie. Kishim kënaqësinë dhe privilegjin të mirëpresim z. Ylli Rashiti dhe z. Lumbardh Vokshi, bashkëthemelues të Get QUALITY, të cilët ndanë njohuritë dhe përvojën e tyre në këtë fushë.

Tema e prezantimit: GetQuality Software - Si të përmirësohet dhe menaxhohet cilësia, ofroi një qasje të re dhe praktike për të optimizuar proceset e menaxhimit të cilësisë në industrinë e përpunimit të drurit. Prezantimi theksoi rëndësinë e adoptimit të zgjidhjeve softuerike moderne për të garantuar një standard më të lartë produktiviteti dhe efikasiteti.

Z. Rashiti dhe Z. Vokshi dhanë një kontribut të çmuar dhe ofruan inspirim për pjesëmarrësit, duke sjellë një vizion të qartë për të ardhmen e kësaj industrie.



2.8 Sesioni 4 - Akademia dhe industria e drurit

Paneli Akademia dhe industria e drurit u moderua nga Miftar Veseli, ALBED dhe të ftuar në këtë panel ishin këta folës: Edmond Hajrizi, Rektor, UBT, Ilirjana Geci, Drejtore per zhvillim te projekteve, AAB, Kushtrim Cukaj, Prorektor USHAF, Flaka Xërxa Beqiri, Prodekane UP, Kreshnik Shehu, CEO, Shehu Academy, Riad Durguti, Menaxher i Projekteve, Dekoriti Training Center.

Qëllimi i këtij paneli ishte të analizojë bashkëpunimin midis institucioneve akademike dhe sektorit industrial të përpunimit të drurit. Për këtë qëllim, diskutimi do të fokusohet në sfidat dhe mundësitë që lindin nga ky bashkëpunim, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave të përshtatura për industrinë, krijimin e mundësive për trajnim praktik dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet studentëve, pedagogëve dhe profesionistëve të sektorit të përpunimit të drurit.

Ndër pyetjet e drejtuara për panelin ishin: Si ndihmojnë universitetet që studentët të angazhohen në projekte reale në sektorin e drurit, në mënyrë që t'i përgatisin ata për tregun e punës? Si i mbështet universiteti studentët që të marrin pjesë në garat studentore për dizajn dhe për të realizuar projekte semestrale? Cili është niveli i bashkëpunimit ndërmjet akademisë dhe industrisë?



Edmond Hajrizi, Rektor i UBT, theksoi se, duke marrë parasysh që industria e drurit është bërë një prioritet edhe në industrinë e Kosovës, jo vetëm përmes dëshirës, por edhe me fakte, si pjesë e akademisë, ne jemi të fokusuar në mbështetje të këtij procesi, sidomos në aspektin e zhvillimit akademik, hulumtues dhe zhvillimor, duke dhënë kontributin tonë në këtë drejtim. Ne kemi Fakultetin e Dizajnit dhe Arkitekturës dhe kemi mundësuar që, brenda strukturës së parkut të UBT-së, të kemi mini-kompani dhe struktura të ngjashme, ku studentët mund të kryejnë praktikat e tyre. Kjo u mundëson atyre të zhvillojnë sjelljen organizative industriale. Po ashtu, studentët kanë mundësinë të shkojnë në kompani të industrisë së drurit, ku realizohen projekte të ndryshme që zhvillohen në bashkëpunim. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se ne jemi fokusuar që fakulteti të ofrojë projekte të bazuara në mësim (project-based learning), të cilat kanë një lidhje shumë të ngushtë me punën praktike. Po ashtu, kemi punuar për të rritur mundësitë e praktikës dhe certifikimeve profesionale, duke lidhur gjithnjë më shumë ciklet akademike me industrinë, për të siguruar që studentët të jenë të përgatitur për kërkesat e tregut të punës.

Ilirjana Geci, Drejtore për Zhvillimin e Projekteve në Kolegjin AAB, theksoi se kolegji fokusohet që programet studimore të jenë ngushtësisht të lidhura me kërkesat e tregut të punës dhe industrisë. Ajo theksoi se një nga mënyrat se si mbështesin studentët për t'u angazhuar në gara të lidhura drejtpërdrejt me industrinë është një komponent shumë i rëndësishëm i AAB-së. Çdo vit, AAB ndan 6 projekte studimore që mbështesin idetë e studentëve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri. Përmes këtyre projekteve studimore, kolegji synon t'u krijojë studentëve lidhje të ngushta me industrinë dhe kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, Kolegji AAB ofron një infrastrukturë të përshtatshme për kreativitetin dhe inovacionin, duke mundësuar zhvillimin e ideve të reja dhe mbështetje për krijimin e mundësive të karrierës për studentët.

Kreshnik Shehu, CEO i Shehu Academy, tha se në 5 vitet e fundit që nga akreditimi i Shehu Academy në profilin e zdrukthtarisë për shkollim profesional, ne kemi trajnuar mbi 500 kandidate, shumica e të cilëve ishin studentë të universiteteve, të cilët kishin kryer bachelor ose studime të mëtejshme, dhe kishin nevojë për aftësi profesionale për t'u përfshirë në proceset e prodhimit dhe për t'u përshtatur për punën praktike. Ai theksoi se kemi pasur një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me Kolegjin AAB dhe Universitetin e Bolonjës, ku kemi realizuar një program ekzekutiv për trajnimin e mbi 15 studentëve, të cilët janë përgatitur për procesin e prodhimit. Shehu shtoi se mendon që duhet të zgjerojmë kapacitetet tona dhe që industria të jetë pjesë aktive e bashkëpunimit me universitetet, pasi ato ndonjëherë kanë vështirësi për të ndjekur trendet reale, duke pasur parasysh se jetojmë në një kohë kur ndryshimet në treg janë shumë të shpejta.

Ai theksoi se si prodhues, ne duhet t'i përshtatemi kërkesave të tregut, dhe kjo mund të realizohet vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet industrisë dhe akademisë. Një shembull i këtij bashkëpunimi është gara e dizajnit, e cila është një mundësi e jashtëzakonshme. Shehu përmendi gjithashtu se kemi raste ku fituesit e këtyre garave sot kanë krijuar biznese të suksesshme në industrinë e drurit.

Flaka Xërxa Beqiri, Prodekane në Fakultetin e Arkitektures / Universitetin e Prishtinës, tha se Fakulteti i Arkitekturës është i përkushtuar për të mbajtur një nivel të lartë të studimeve, por gjithashtu përmes iniciativave në bashkëpunim me universitete të ndryshme ndërkombëtare, ai është duke reformuar vazhdimisht programet studimore për t'i përgatitur studentët më mirë për tregun e punës. Ajo theksoi se kohët e fundit kemi zhvilluar edhe bashkëpunime me kompani për të ruajtur shpirtin artistik të studentëve, duke i angazhuar ata në gara të ndryshme, si gara studentore në dizajn, si dhe gara ndërkombëtare. Po ashtu, jemi fokusuar në përgatitjen e fakultetit tonë me infrastrukturë teknike moderne, dhe se kohët e fundit jemi pajisur me teknologji të ndryshme, përfshirë paisje CNC, që i mundësojnë studentëve të modelojnë punimet e tyre dhe të përgatiten më mirë për kërkesat e industrisë.

Kushtrim Cukaj, Prorektor i USHAF, tha se ne si USHAF i japim shumë rëndësi angazhimit të studentëve që nga fillimi i vitit të parë, duke i përfshirë ata në projekte të drejtpërdrejta gjatë zhvillimit të lëndëve të caktuara, dhe veçanërisht në angazhimin e tyre në industri, përkatësisht në kompani të ndryshme me të cilat kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm. Ky bashkëpunim ka sjellë rezultate të jashtëzakonshme.

Riad Durguti, Menaxher i Projekteve në Dekoriti Training Center, tha se Dekoriti Training Center jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë, duke marrë pjesë aktivisht në ekosistemin e zhvillimit industrial. Ky kontribut ndikoni në kalimin nga një ambient akademik në një mjedis ku studentët shtojnë njohuritë praktike dhe realisht ndikojnë në procesin e prodhimit. Në rolin tonë, e shohim veten si ata që plotësojmë finesat që i duhen një profesionisti të ri, për t'u bërë gati për t'u angazhuar aktivisht në procesin e punës.

3. Ekspozimi i produkteve

Ekspozimi i produkteve është hartuar me qëllim që të paraqesë aftësitë e përgjithshme të sektorit të drurit në Kosovë dhe të funksionojë si një prezantim për blerësit dhe agjentët e shitjes. Organizimi i ekspozites së produkteve është bërë në atë strukture që çdo kompani pjesëmarrëse të ketë një zonë ekspozimi të dedikuar. Organizimi i kësaj ekspozite ka një rëndësi thelbësore për ndikimin pozitiv në imazhin e sektorit të drurit, duke i bërë të qartë dhe të shndritshëm vlerat dhe potencialet që ai sjell në treg. Përveç prezantimit të produkteve, kjo ngjarje ka rolin e theksuar të krijuar një ambient ku kompanitë mund të ndajnë eksperiencat, njoftojnë për inovacionet e tyre dhe sigurojnë një platformë për bashkëpunim dhe zhvillim të mëtejshëm të sektorit. Për të garantuar një paraqitje të suksesshme dhe efektive, ishte e rëndësishme që të gjitha kompanitë anëtare të kishin produkte të reja në dispozicion dhe të ishin të gatshme për të ekspozuar.

Kompanitë që morën pjesë në ekspozimin e produkteve ishin:

1. Pro Credit Bank	**6. Orendi**	**11. Treventi**	**16. Dardania Model**	**21. Lux Dekor Rasic**
2. Raiffeisen Bank	**7. Promobi**	**12. Shehu**	**17. KIT**	**22. MS dizajn**
3. Elnor	**8. AE Team**	**13. Albed**	**18 . ALFA Wood Group SA**	**23. LA Guster DIY**
4. Hoti Excluzive	**9. Bizzarro**	**14. Ansel**	**19. Get QUALITY**	**24. Zeta Coorporation**
5. Vater 1954	**10. Mercom**	**15. Maxx Qeramika**	**20. Swiss Crono**	

Qendrat e trajnimit në industrinë e drurit që morën pjesë në ekspozitë ishin:

1.Akademia SHEHU dhe
2.Qendra e Trajnimeve Dekoriti

Qëllimi i kësaj ekspozite te Qendrave ishte t'i informonte të pranishmit rreth qendrave trajnuese që kanë filluar të ofrojnë shërbime trajnimi për stafin në fushën e zdruktarise. Këto qendra trajnuese ofrojnë module të ndryshme trajnuese, të cilat kanë qenë mungesë për kohë të gjatë në industrinë e drurit.






ALBED
Dizajn
Prodhim
Montim




VATËR 1954


orendi



Raiffeisen
Bank


KIT










DARDANIA MODEL


HOTI
HOTI


AE
TEAM

4.1.Takimet Biznes me Biznes - B2B gjatë Konventës së Industrisë së Drurit në Kosovë

Në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, kompania “Cut to Create Media” dhe platforma “Rrëfim Suksesi”, organizuan një ngjarje të rëndësishme që përfshiu takime B2B me qëllim lidhjen e bizneseve të diasporës me ato të Kosovës. Kjo nismë kishte për qëllim promovimin e bashkëpunimit dhe zgjerimin e mundësive për eksport përmes rrjetëzimit dhe shkëmbimit të informacionit. Si rezultat u zhvilluan gjithsej 81 takime B2B, të cilat ishin shumë produktive. Bizneset nga diaspora u befasuan pozitivisht nga mundësitë që ofron Kosova dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtejshëm. Ekipi I Cut to Create Media realizoi një video përmbledhëse prej rreth 11 minutash, që shfaq momentet më interesante nga ngjarja. Videoja përfshin:

Momente nga ngjarja: Mikpritja e bizneseve dhe përfaqësuesve, procesin e prezantimeve dhe diskutimeve, si dhe atmosferën gjatë takimeve B2B.
Intervista të personalizuara: Pjesëmarrësit ndanë përshtypjet e tyre për ngjarjen, mundësitë për bashkëpunim dhe idetë për të ardhmen.

Përmbajtje motivuese: Promovimi i suksesit të ngjarjes dhe ndikimi pozitiv në krijimin e partneriteteve të reja.

https://youtu.be/xKIRwI7GWVs?si=uJoPy15CGfQpxF2p
https://www.facebook.com/share/v/fP75emSewu92BeNi/

Takimet B2B dhe Konventa e Industrisë së Drurit kanë ofruar mundësi të shumta për bashkëpunim ndërmjet bizneseve të diasporës dhe atyre kosovare. Kompanitë pjesëmarrëse kanë shprehur vullnet të fortë për të vijuar me takime dhe për të konkretizuar marrëveshjet në të ardhmen e afërt. Ngjarja ka pasur një ndikim të dukshëm në promovimin e mundësive për eksport dhe forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të biznesit.










5. Gara studentore për dizajn - Edicioni i shtatë

Stafi i SHPDK ka bashkëpunuar me pesë universitete/kolegje të ndryshme, përfshirë UBT, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, AAB, si dhe Fakultetin e Arkitekturës UP dhe Innovation Center Gracanica. Ata kanë planifikuar dhe organizuar sesione informuese rreth garës studentore për dizajn. Ekipi i SHPDK ka procesuar krijimin e konceptit dhe mënyrën e aplikimeve nga ana e studentëve, si dhe organizimin e Garës Studentore brenda secilit universitet. Vlen të theksohet se, për herë të parë në këtë edicion, SHPDK, me mbështetje nga USAID Kosovo Compete Activity, ka përfshirë në garën studentore studentët nga minoritetet, duke bashkëpunuar me Innovation Center Gracanica, e cila organizoi pjesëmarrjen e pesë studenteve në garën për dizajn. Këta studente ekspozuan punimet e tyre në Konventën e Industrisë së Drurit dhe u pajisën me certifikata si finaliste të garës.

Nga universitetet, pritej që secili prej tyre të delegonte 8-10 finalistë për ekspozim gjatë Konventës së shtatë të industrisë së drurit, e cila u organizua më 26 Nëntor 2024.

SHPDK ofronte per Universitetet :

1. Krijimin e kritereve dhe mënyres së aplikimit për studentë.
2. Regjistrimin dhe informatat në platformen : www.kosovowood.org/gara
3. Cmimet: vendi i parë, vendi i dytë dhe vendi i tretë
4. Panelet ekspozuese deri në 50 punime në total gjatë Konventës
5. Dizajnimin e banerave B1
6. Prezantimin e punimeve në katalogun e dizajnuar nga SHPDK

Formimi i një komisioni vlerësues për zgjedhjen e çmimeve ishte një hap i rëndësishëm për sigurimin e objektivitetit dhe pavarësisë së vlerësimit. Në këtë rast, komisioni është i përbërë nga: 4 përfaqesuese te Universiteteve, 1 përfaqesues nga SHPDK dhe 1 ekspert I pavarur kishte për qëllim të sigurojë një proces vlerësues të drejtë, të pavarur dhe të përfshirë, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë studentët pjesëmarrës.

SHPDK organizoi mbledhjen e komisionit vlerësues me date 26.11.2024 nga ora 10:00 deri 13:00 në sallen Vivaldi.

Ndër kriteret kryesore ishin:

• Inovacioni vlen 50% • Dizajni vlen 30% •Mundësia e lansimit në treg vlen 20%

Anetarët e Komisionit ishin:

1. Muharrem Sejdiu – UBT
2. Dashmir Selmani – Ekpert i Pavarur (Arkitekt)
3. Flaka Xërxa – Fakulteti i Arkitekturës
4. Kushtrim Cukaj – USHAF
5. Valon Xhelili – AAB
6. Miftar Veseli - SHPDK

Lista e 3 studentëve të cilët u përzgjodhën nga komisioni vlerësues për 3 çmimet fituese është si vijon:

1. Liburn Shaqiri, UBT - Vendi 1re = 1000 Euro
2. Erzon Derguti,USHAF - Vendi 2te = 700 Euro
3. Bledar Hazrolli, FA/UP - Vendi 3te = 500 Euro

Ekipi i SHPDK-së ka koordinuar me sukses shpërndarjen e çertifikatave për të gjithë finalistët dhe ka ndarë çmimet për vendin e parë, të dytë, dhe të tretë.










6. PËRMBLEDHJE

Konventa e shtatë e Kosovës për Industrinë e Drurit ishte një ngjarje shumë e suksesshme, duke mbledhur mbi 350 pjesëmarrës të regjistruar, përfshirë përfaqësues nga sektori i industrisë së drurit dhe publiku gjerësisht. Praninë institucionale e karakterizoi një pjesëmarrje e qëndrueshme e përfaqësuesve nga qeveria: Kryeministri i Kosovës, ministra dhe ambasador te ndryshëm gjatë gjithë ngjarjes.

Edicioni i shtatë i Konventës së Industrisë së Drurit në Kosovë u pasqyrua gjerësisht nëpërmjet shumë kanaleve të ndryshme, duke përfshirë televizionet, radio, media të shkruara dhe platformat online të lajmeve. Televizionet, përfshirë RTK, transmetuan ngjarjen drejtpërdrejt. Gjithashtu, dy intervista u zhvilluan në vendin e konventës me drejtoreshën ekzekutive, Znj. Arieta, për emisionet televizive KTV dhe RTK. Kjo bëri që konventa të marrë një ekspozim të gjerë në media, duke ndikuar në ndërgjegjësimin dhe interesin e publikut në lidhje me sektorin e industrisë së drurit në Kosovë.

Pjesëmarrësit në forume dhe panelet e ndryshme ishin në gjendje të diskutonin dhe analizonin çështjet përkatëse, duke pasur mundësinë të shprehnin shqetësimet e tyre dhe të merrnin përgjigje. Kjo prezantoi një platformë të hapur dhe interaktive ku pjesëmarrësit mund të ndanin pikëpamjet, përvojat, dhe pyetjet e tyre, duke krijuar një mjedis të pasur në shkëmbimin e ideve dhe debatit konstruktiv.

KWIC ishte rasti i përsosur për të promovuar kompanitë e industrisë së drurit dhe për të ndarë detaje rreth planeve të ardhshme të SHPDK-së. Konventa u transmetua drejtpërdrejt edhe në Facebook, duke fituar shumë shikues: 100 000 shikues.
Objektivi kryesor i Konventës së Industrisë së Drurit në Kosovë (KWIC) ishte përqendrimi i vëmendjes në Industrinë e Drurit të Kosovës dhe promovimi i eksportit, inovacionit dhe dizajnit. Me mbështetjen e folësve dhe ekspertëve, si dhe me prezantimin e produkteve nga kompanitë dhe ideve novatore të studentëve, ky objektiv u arrit plotësisht. Duke qenë një ngjarje vjetore tani, KWIC ka bërë një kontribut të rëndësishëm në tërheqjen e kompanive, projektuesve, arkitektëve të ardhshëm, institucioneve, agjencive dhe ekspertëve për të diskutuar, takuar dhe shkëmbyer informacion. Kjo ngjarje ka një potencial të madh për të përmirësuar sektorin e industrisë së drurit në nivel lokal dhe për t'i hapur rrugë inovacionit dhe bashkëpunimit në këtë fushë.

Vlerësimi nga pranishmëria, mediat, dhe publiku në përgjithësi konfirmoi se Konventa ishte një ngjarje shumë e suksesshme.

Aktivitetet e planifikuara gjatë konventës u vlerësuan si shumë të suksesshme, duke krijuar një hapësirë të favorshme për zhvillimet e ardhshme dhe ngjarje të ngjashme në fushën e industrisë së drurit. Kjo tregon për një përpjekje të madhe dhe një përgatitje të shkëlqyeshme nga Bordi i SHPDK dhe ekipi i organizatorëve në realizimin e një ngjarjeje të tillë të rëndësishme dhe ndikuese në sektorin e tyre.



7. REKOMANDIME

- Autoritetet vendore dhe kompanitë duhet të punojnë së bashku për të përmirësuar imazhin e vendit në skenën ndërkombëtare. Komunikimi efektiv dhe promovimi i aspekteve pozitive të vendit do të ndihmojnë në krijimin e një imazhi pozitiv që tërheq investitorë dhe klientë të huaj.
- Kompanite duhet te fokusohen ne Investimet në infrastrukture, teknologji dhe digitalizim si mjet për të përmirësuar operacionet e tyre dhe për të qëndruar në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e tyre të industries dhe përshtatjen ndaj kërkesave të tregut ndërkombëtar.
- Inkurajimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit mes sektorit privat, institucioneve shtetërore, dhe agjencive të zhvillimit mund të forcojë përpjekjet për rritjen e ekonomisë dhe konkurrueshmërisë së bizneseve lokale.
- Zhvillimi i politikave dhe programeve që ofrojnë incentiva për eksportin dhe investimet e huaja mund të ndihmojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së industrive vendase dhe në tërheqjen e investitoreve.
- Nxitja e investimeve nga diaspora dhe përdorimi i misioneve B2B me diasporën mund të sjellë avantazhe për ekonominë vendase dhe ndihmon në rritjen e eksportit.
- Përdorimi i kampanjave promovuese digjitale dhe pjesëmarrja në ngjarje ndërkombëtare si ekspozita dhe panairë janë mjetet e nevojshme për të rritur njohurinë dhe prezencën e bizneseve lokale në tregjet ndërkombëtare.
- Përmirësimi i fuqisë punëtore përmes trajnimeve, kurseve dhe investimeve në aftësi të reja është thelbësore për zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e konkurrueshmërisë në treg.

Disa nga linqet mbi raportimet për Konventë:

https://www.youtube.com/watch?v=Ts5J00okz_c
https://klankosova.tv/konventa-e-drurit-kurti-kosova-po-e-gdhend-nje-vend-te-vecante-ne-tregun-global/
https://kosova.info/sot-hapet-konventa-e-industrise-se-drurit-te-kosoves/
https://www.facebook.com/reel/453798017426228
https://www.facebook.com/kosovowoodassociation/videos/1971087116722907

Mbështetur nga:











